



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:148884
Datë: 01.02.2024
Numri i dokumentit: 05273097

C.nr.403/2022

C.nr.455/2022

C.nr.786/2022

C.nr.1406/2022

GJYKATA THEMELORE GJILAN-, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtares Florije Qerimi, me bashkëpunatoren profesionale Shkurte Kadriu në çështjen juridike kontestimore të paditëses K. K. për D. dhe F. me E. E. Sh.A (K.) me seli në P., kundër të paditurës Nebahate F. K. nga Gj. Rr.“A. T.”, pa nr., me objekt kompensim dëmi material, jashtë seancës, më datë 27.04.2023, mori këtë :

A K T V E N D I M

Bëhet bashkimi i lëndëve kontestimore C.nr.403/2022, C.nr.455/2022, C.nr.786/2022 dhe C.nr.1406/2022, sipas paditëses K K për D dhe F me E E Sh.A (K) me seli në P, kundër të paditurës N F K nga Gj, ashtu që lëndët e bashkuara do të evidentohen me numrin C.nr.403/2022.

A r s y e t i m

Pranë kësaj gjykate, janë në zhvillim e sipër proceset kontestimore C.nr.403/2022, C.nr.455/2022, C.nr.786/2022 dhe C.nr.1406/2022, me paditës K K për D dhe F me E E Sh.A (K) me seli në P, kundër të paditurës NF K nga Gj. Në të dy lëndët e lartcekura objekt i kontestit është kompensimi i dëmit material.

Pasi që në të gjitha lëndët kontestimore, bëhet fjalë për palët e njëjta ndërgjyqëse dhe me objekt të njëjtë të kërkesëpadisë, me ç’rast edhe provat të cilat do të administrohen janë të njëjta, gjykata vlerëson se bashkimi i këtyre lëndëve është në funksion të realizimit të parimit të ekonomizimit të procedurës kontestimore, ngase në këtë mënyrë shpejtohet vendosja dhe zvogëlohen shpenzimet procedurale.

Këtë mundësi të bashkimit e ka përcaktuar dispozita e nenit 387, pika h e LPK-së, në të cilën thuhet se: “*Me qëllim që çështja të përgatitet sa më mirë për tu zgjidhur shpejt e drejt, gjykata*

nga momenti i arritjes së padisë e deri në momentin e caktimit të seancës për shqyrtim kryesor të çështjes me aktvendim vendosë për veçimin apo bashkimin e dy proceseve gjyqësore”.

Andaj, nga sa u tha më lartë, e duke u bazuar në nenin 408.1 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendim.

Gjykata Themelore Gjiilan-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.403/2022, më datë 27.04.2023

Gjyqtarja
Floriqe Qerimi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Numri i lëndës: 2022:148884
Datë: 01.02.2024
Numri i dokumentit: 05273097